



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Paneli i Apelit ka caktuar shqiptimin e Aktgjykimit të apelit për këtë çështje, për të martën, 15 korrik 2025, në orën 10:00 të paradites.

Trupi Gjykues e shpalli z. Shala fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme më 16 korrik 2024, dhe e dënoi me 18 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim. Gjykatësit lëshuan edhe Urdhrin për Zhdëmtim lidhur me viktimat në këtë çështje dhe urdhëruan z. Shala të paguante shumë prej 208.000 eurosh si kompensim për dëmin fizik, mendor dhe material që u kishte shkaktuar viktimave të krimeve për të cilat u shpall fajtor.

Z. Shala e apeloj Aktgjykimin dhe seanca e apelit u mbajt në maj të këtij viti.

Paneli i Gjykatës së Apelit mund ta lerë në fuqi, prapësojë, ose ndryshojë aktgjykimin e Trupit Gjykues.

Mbrojtja e Shalës ka dorëzuar po ashtu apel më vete kundër Urdhrit për Zhdëmtim.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, Trupi Gjykues vendosi javën e shkuar lidhur me dy kërkesa nga Prokuroria për pranim provash.

Në një prej vendimeve, Trupi Gjykues miratoi mocionin e Prokurorisë për të pranuar si prova një numër dokumentesh që kanë të bëjnë me viktimat e pretenduara të vrasjeve të paligjshme në këtë çështje gjyqësore, por rrëzoi kërkesën e Prokurorisë për të shtuar një material tjetër në listën e provave materiale.

Në vendimin tjetër, Trupi Gjykues miratoi pjesërisht kërkesën për të pranuar një numër raportesh ndërkombëtare si prova, ku pranoi disa prej tyre të kërkuar nga Prokuroria dhe nuk pranoi pjesën tjetër.

Sa u përket hapave të ardhshëm në këtë çështje, ekipet e Mbrojtjes kanë bërë me dije synimin e tyre për të dorëzuar mocion ku do të kërkojnë rrëzimin e disa ose të të gjitha akuzave. Sipas rregullës 130, Trupi Gjykues mund të rrëzojë disa ose të gjitha akuzat në qoftë se nuk ekzistojnë prova në mbështetje të një vendimi fajësie jashtë dyshimit të arsyeshëm në lidhje me akuzat në fjalë. Ky parashtrim me shkrim nga Mbrojtja pritet në qershor, pas të cilit Prokuroria do të ketë 30 ditë për t'u përgjigjur.

Pas kësaj, Trupi Gjykues do të vendosë lidhur me kërkesat për rrëzimin e akuzave. Gjatë kohës që pritet dalja e vendimit, Mbrojtja duhet të informojë nëse planifikon të paraqesë prova dhe, nëse po, sa dëshmitarë planifikon të thërrasë.

